



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 1

Prishtinë, më 18 mars 2010, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, TË PUNËS
DHE TË MIRËQENIES SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Sasha Gjokiq, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Nazane Breca, Aurora Bakalli dhe Gëzim Kelmendi.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj - administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës, Lejla Selimi –OSBE, Natyra Kasumaj - KDI, Ervin Ibrahim – UNDP dhe Qëndresa Ismaili – praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

Mbledhja konstituive e Komisionit

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së rendit të ditës.

Kryetari **Fikrim Damka** i njoftoi anëtarët e Komisionit me përbërjen e tij dhe të stafit mbështetës. Ai tha se deputetët, anëtarë të Komisionit, janë përfaqësues të partive të ndryshme, por qëllimet i kemi të përbashkëta, të gjithë do të punojmë për të mirën e popullit dhe nuk do të kemi ndasi gjatë punës sonë. Kemi marrë disa materiale nga mandati i kaluar, me marrjen e strategjisë nga Qeveria dhe do ta hartojmë edhe planin e punës.

Time Kadrijaj – I përshëndeti të pranishmit dhe tha se ky komision do të ketë shumë punë, sepse gjendja në shëndetësi është shumë e rëndë. Shpresoj në bashkëpunim pasi shumica jemi profesionalist të fushës së shëndetësisë. Me arritjen e strategjisë do ta hartojmë edhe planin e punës.

Fikrim Damka – Tha se Projektligji për Këshillin Ekonomik Social dhe Projektligji për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve dhe Veteranëve, pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, pritet të vijë shumë shpejt për miratim, pasi në mandatin e kaluar kanë kaluar në lexim të parë dhe kanë qenë në procedurat e miratimit në Komision.

Salihe Mustafa – Tha se në këtë komision po ndihem mirë dhe bashkë me kolegët do të mundohemi që të arrijmë rezultate të mira, pasi shëndetësia është në gjendje të vështirë.

Flora Brovina – I uroj anëtarët e rinj të Komisionit. Ajo tha se ky komision gjithmonë ka punuar mjaft shumë dhe me konsensus të plotë. Synimi ynë do të jetë miratimi i Ligjit për sigurime shëndetësore, plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për shëndetësi dhe miratimi i Ligjit për sigurime shoqërore. Gjithashtu duhet punuar edhe në çështjen e pensioneve të bashkatdhetarëve tanë në Zvicër. Shëndetësia dhe çështjet sociale janë dy lëmi me shumë probleme dhe na presin shumë sfida. Nga Ministria e Shëndetësisë do të bëhen shumë reforma shëndetësore dhe ne do të jemi vigjilent dhe t'i përcjellim ato reforma.

Nazane Breca – Tha se Ligji për urgjencat shëndetësore ka mangësi dhe duhet të plotësohet sa më parë. Ligjet e miratuara, shumica, nuk janë funksionale. Sa më parë duhet të miratohet Ligji për sigurime shëndetësore, se pa miratimin e këtij ligji nuk ka suksese në shëndetësi.

Bahri Thaçi – Tha se reformat në shëndetësi duhet të bëhen me kujdes dhe sidomos duhet pasur kujdes gjatë miratimit të Ligjit për sigurime shëndetësore. Duhet bërë presion në Qeverinë që të rritet buxheti për shëndetësi.

Flora Brovina – Propozoi që në mbledhjen e radhës të shqyrtohet Projektbuxheti i Kosovës në lëmin e shëndetësisë dhe punës e mirëqenies sociale.

Aurora Bakalli – Tha se buxheti për shëndetësinë është rritur për 7 milionë, por prapë nuk priten përmirësime në shëndetësi, sepse buxheti për mallra dhe shërbime dhe për investime kapitale është zvogëluar për 4 milionë. Buxheti për këta dy sektorë është dashur të rritet, e jo të zvogëlohet.

Gëzim Kelmendi – Tha se edhe në sektorin e stomatologjisë nuk është paraparë kurrfarë investimi.

Të gjithë anëtarët e Komisionit u pajtuan që mbledhjet e rregullta të Komisionit të jenë në ditën e mërkurë, në orën 11:00. U kërkua që të gjithë anëtarëve të Komisionit t'u përcillet raporti i punës nga mandati i kaluar, një raport i monitorimit të ligjit, si dhe dokumenti i përbashkët me UNDP- lidhur me gjendjen në shëndetësi.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përqatiti:

Njësitia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka